



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafët 3 dhe 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5, paragrafi 1, lidhur me nenin 7, paragrafin 3, dhe nenin 19, paragrafin 3, të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, dhe pikën 4 të Rezolutës 06/R-013 të 12 korrikut 2018 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Telekomi i Kosovës" Sh.A.
2. Shfuqizohen vendimet 09/38 i 29 marsit 2018, 10/81 i 24 dhjetorit 2018 dhe 03/106 i 11 qershorit 2019 të Qeverisë për emërimin e drejtorëve.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për të vlerësuar gjendjen, është marrë parasysh Raporti i auditimit të Ndërmarrjes "Telekomi i Kosovës" për vitin financiar të përfunduar me 31 dhjetor 2018, nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA).


Sipas nenit 7.3 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Qeveria mund t'i shkarkojë drejtorët nëse, për dy vjet radhazi, ndërmarrja nuk përmbush planin e biznesit, u bie vlera asetëve të ndërmarrjes, ose rritet pakënaqësia e konsumatorëve me shërbimet. Duke u mbështetur në raportin e ZKA-së (fq. 15-20, 27, 51-52), Qeveria konstaton se janë plotësuar kushtet për shkarkimin e drejtorëve.

Sipas nenit 19.3, Qeveria duhet t'i shkarkojë drejtorët menjëherë nëse ka "arsye për të besuar" se kanë shkelur detyrat fiduciare. Duke pasur parasysh raportin e ZKA-së (fq. 9-10, 20-27), Qeveria vëren se drejtorët kanë lejuar shpenzime të tepërta, punësime e gradime pa kriter, si dhe kontrata për mallra e shërbime, në kundërshtim me mundësitë, nevojat dhe zotimet e ndërmarrjes për ulje shpenzimesh e rritje të hyrash. Rijedhimisht, Qeveria konstaton se ka arsye për të besuar se drejtorët kanë shkelur detyrat fiduciare, për çka duhet të shkarkohen.

Përfundimisht, pika 4 e Rezolutës 06/R-013 të Kuvendit të Republikës së Kosovës gjithashtu kërkon shkarkimin e drejtorëve të ndërmarrjes. Sipas nenit 92, paragrafit 3, të Kushtetutës, Qeveria duhet t'i zbatojë rezolutat e Kuvendit.

Prandaj, mbështetur në normat dhe gjetjet e sipërcekura, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Telekomi Kosovës" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/03

Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 dhe 32 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të nenit 14 të Rregullores Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Sekretarët e Përgjithshëm nga ministritë e prekura nga riorganizimi sipas Vendimit Nr. 07-V-005 të dt. 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës, kalojnë në listën tepricë sipas legjislacionit në fuqi për shërbimin civil.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, ministritë e prekura nga riorganizimi janë: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Ministria e Financave dhe Transfereve, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, si dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit.
3. Qeveria e Republikës të Kosovës do të shqyrtojë mundësinë e ricaktimit të Sekretarëve të Përgjithshëm nga pika 2 e këtij vendimi në pozita ekuivalente apo do t'i trajtojë sipas rregullimit ligjor për nëpunësit tepricë, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave dhe Transfereve si dhe Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 16 dhe 32 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të nenit 14 të Rregullores Nr. 06/2012 për Pozitat e Larta Drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Izedin Bytyqi, në përputhje me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/20 të dt. 19.02.2020, i emëruar (vazhduar mandati) me Vendimin e Qeverisë Nr. 09/50 të datës 05.06.2018 si Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ricaktohet në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ambientit.
2. I ricaktuari nga pika 1 e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi deri në përfundimin e mandatit sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 09/50 të datës 05.06.2018, ligjit dhe akteve nënligjore që rregullojnë marrëdhënien e punës në shërbimin civil.
3. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/03

Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizues për manifestimin gjithë popullor për shënimin e Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili do të organizohet nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, me datë 5, 6 dhe 7 mars 2020, në këtë përbërje:
 - 1.1. Haki Abazi, zëvendëskryeministër i dytë, kryesues;
 - 1.2. Anton Quni, Ministër i Mbrojtjes, anëtar;
 - 1.3. Përfaqësues, Zyra e Kryeministrit, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues, Komuna Skenderaj, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike, anëtar.
 - 1.8. Përfaqësues nga Familja Jashari.
2. Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill Organizues:
 - 2.1. Zyra e Presidentit, anëtar;
 - 2.2. Kuvendi i Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, anëtar;
 - 2.4. Asociacioni i Komunave të Kosovës, anëtar, dhe
 - 2.5. Përfaqësues të OJQ-ve.
3. Obligohet Këshilli Organizues dhe institucionet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 02/59, i datës 17 nëntor 2015, Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 03/51 i datës 12 qershor 2018 dhe Vendimi Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/111 i datës 19 korrik 2019.
2. Shfuqizohet pika 5. e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/02 të datës 12 shkurt 2020.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Transfereve dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe zbatohet nga data 3 shkurt 2020.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/03

Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Francës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë që të zhvillojë negociatat me Qeverinë e Republikës së Francës me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartëcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ekstradim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Francës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë që të zhvillojë negociatën me Qeverinë e Republikës së Francës me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartëcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/03
Datë: 19.02.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 29 të Ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 shkurt 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 393,474 euro, për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Financave me kod 201, nën programi Kontigjencat në Ministrinë e Financave me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe transferohen në Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232, nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, në kategorinë e shpenzimeve të rezervës. Këto mjete transferohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (320) në nën-programin Zgjedhjet me kod 14200, në kategorinë shpenzimeve mallra dhe shërbime shuma prej 393,294 euro dhe kategorinë shpenzime komunale shuma prej 180 euro.
3. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij vendimi mund të përdoren vetëm për organizimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në Podujevë në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe shpenzime komunale dhe mjetet e pashpenzuara duhet të kthehen në buxhetin e Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë